



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0513

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahim - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “PATRONI” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a., më 19/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “PATRONI” SH.P.K., me nr. 2024/0513, e datës 14/06/2024, ndërsa, vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)”, me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a. anulohet, ndërsa, aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.01.2024, “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, ndërsa me datën 22.05.2024 ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE “Ex Fis.” SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 6,650,000.00 €.

Me 27.05.2024, OE “PATRONI” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.06.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14/06/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “PATRONI” SH.P.K., me nr. 2024/0513 lidhur me aktivitetin “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Ne kemi pranuar Kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin të prokurimit “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË - MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër prokurimit KEK-24-186-1-1-1, ku ju pretendoni

se dispozitat e LPP-së janë shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktues,.

Për informatën tuaj bazuar ne pretendimin e juaj ankimor dhënë ne kërkesën për rishqyrtim ju japim ne vazhdim përgjigjet bazuar ne kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimi i juaj se Dispozitat ligjore ne vijim janë shkelura nga Autoriteti Kontraktues, nuk qëndron dhe ju japim përgjigje në vazhdim.

Komisioni profesional teknik i rivlerësimit për këtë aktivitet të prokurimit I ka vlerësuar, krahasuar dhe ekzaminuar ofertat e ofertueseve që kanë konkurruar .

Për pretendimin e parë të juaj, ju njoftojmë se deklarata mbi afatin e furnizimit, mbi sasinë e furnizimit dhe përshkrimin e çmimit (duke bërë krahasimin e nënshkrimit në dokumentet tjera) nuk janë të nënshkruara nga personi i autorizuar i Lumë Muharremi. Prandaj për të e sqaruar dokumentet e lartcekura nga cili person janë nënshkruar dhe se ky person a është i autorizuar për nënshkrimin e këtyre dokumenteve, kemi parashtruar pyetje sqaruese duke u bazuar në Rregulloren Nr.001_2022 për prokurimin publik sipas nenit Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 40.8 si dhe sipas nenit Neni 38 Sqarimi i Tenderëve, paragrafi 38.5 duke mos e anashkaluar edhe LPP nenin Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminim dhe nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë paragrafin 3 ku kemi kërkuar sqarime.

Përgjigjen e kemi marr dhe komisioni i rivlerësimit bazuar në dokumentin e pranuar në kuadër të sqarimeve ka vlerësuar ofertën e operatorit ekonomik të shpallur fitues në bazë të Vendimit të AK si oferte e përgjegjshme.

Pretendimi tjetër i juaji që oferta e propozuar për dhëni të kontratës është ofertë jo-normalisht të ulëta nuk qëndron sepse bazuar në raportin e hapjes së ofertave nuk konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët, pra nuk përmbushen të gjitha sipas nenit Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, paragrafi 41.3.

Kështu që komisioni i rivlerësimit pas përgjigjes të pretendimit të cekura më lartë, rrinë pranë qëndrimit të vetë që ka dhënë me herët dhe që ka rekomanduar për kontratë OE “EX FIS” nga Prishtina.”

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PATRONI” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: pretendimet ankimore të OE ankues:

Fillimisht Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me dt.25.03.2024 ku ishte rekomanduar për kontratë OE “Ex Fis SHPK” me çmim prej: 109.00 € dhe total prej:6,381.572.14 €.

Neve kishim pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Pastaj, me dt.02.04.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Kërkesa për rishqyrtim ishte aprovuar me dt.05.04.2024 dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim.

Prej datës së aprovimit të kërkesës për rishqyrtim, pra prej dt.05.04.2024, deri me dt. 22.05.2024 nuk është kryer rivlerësimi dhe rishqyrtimi, ku çështja e vetme që është rishqyrtuar ka qenë nënshkrimi i deklaratës për afat të liferimit dhe paramasës dhe përshkrimi i çmimeve pa autorizim.

Ne, përveç që kishim pasur qasje pas vlerësimit të parë tek oferta e OE të rekomanduar për kontratë, edhe tani pas njoftimit mbi vendimin të dt.22.05.2024 kemi marrë qasje në dokumente dhe kemi vërejtur se autoriteti kontraktues gjatë tërë kësaj periudhe ka ndërmarrë vetëm një veprim, ku me dt. 17.05.2024 ka kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me nënshkrimin e deklaratës mbi afatin e liferimit dhe nënshkrimin e paramasës.

Nga qasja në këto dokumente, kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë përgjigje me dt. 17.05.2024, ku ka theksuar se personi i cili i ka nënshkruar këto dokumente është z. Fatbardh Muharremi i lindur me 02.11.1978 dhe numër të ID. 1004811905, i cili është përfaqësues i autorizuar i kompanisë EXFIS shpk.

Me këtë përgjigje, është bashkangjitur edhe një autorizim i përgjithshëm i dt. 14.01.2022 për Fatbardh Muharremi i lëshuar nga Drejtori Menaxhues Lum Muharremi, i cili autorizim figuron se është noterizuar tek Noter Learte F. Cena.

Ne, edhe në kërkesën për rishqyrtim të dt.02.04.2024 kemi pas pretendim se deklarata nën betim, deklarata për specifikime teknike, deklarata për prodhuesit janë të nënshkruara në emër të Lum Muharremi që figuron Drejtor, ndërsa deklarata për afat të liferimit dhe paramasa dhe përshkrimi i çmimeve janë të nënshkruara nga dikush tjetër e jo nga Drejtori.

Sa i përket autorizimit të prezantuar me sqarime, sqarojmë se ky autorizim nuk mund të merret parasysh dhe nuk është valid sepse në njërin anë shkruan autorizim gjeneral, ndërsa në brendi janë cek rastet kur mund të përfaqësojë dhe nënshkruaj në emër të drejtorit Lum Muharremi.

Në brendi të këtij autorizimi, askund nuk shkruan se i njëjti ka të drejtë të nënshkruaj në emër të drejtorit dokumentet të tenderit apo deklarata për liferim të mallit apo paramasën dhe përshkrimin e çmimeve.

Përveç këtij fakti, nënshkrimi nëpër deklarata që ne i kemi kontestuar nuk dihet se i cilit person është.

Më poshtë shihen nënshkrimet tek deklarata për afat të liferimit.

Ky nënshkrim nuk është valid, sepse ekziston vetëm një nënshkrim dhe nuk dihet se i kujt është ky nënshkrim. Siç shihet nënshkrimi nuk është bërë në emër të drejtorit, pra nuk është nënshkruar për Lum Muharremi, prandaj ky nënshkrim është i parregullt dhe jo valid.

Më poshtë është paramasa me përshkrim të çmimit, ku shihet që tek nënshkrimi shkruan “për” dhe nuk dihet se për kënd flitet në këtë rast. Ky nënshkrim nuk është i vlefshëm sepse nuk kemi nënshkrim valid nga personat kompetent.

Edhe në këtë dokument nuk kemi nënshkrim për Lum Muharremi, i cili është drejtor, por tek ky dokument tek rubrika nënshkrimi shënohet “për”, ndërsa është një nënshkrim që nuk dihet i kujt është dhe për kënd është nënshkruar. Në këtë rast, tek rubrika nënshkrimi vetëm është shënuar për. Në secilin variant, në këtë rast nuk kemi nënshkrim të rregullt dhe valid. Në asnjërin dokument nuk është nënshkruar Për drejtorin dhe po ashtu nuk dihet se i kujt është nënshkrimi. Madje tek përshkrimi i çmimit po i bie se për dikend tjetër po nënshkruan dikush tjetër. Pra jo Për Lum Muharremin, por për një person tjetër po nënshkruan dikush tjetër.

Duke pasur parasysh këto sqarime dhe dëshmi, rezulton se autorizimi i bashkangjitur me sqarime nuk mund të merret parasysh, sepse askund nuk vërtetohet se i njëjti person ka nënshkruar këto dokumente, pasi që të njëri dokument është vetëm një nënshkrim, kurse tek tjetri ekziston fjala “PËR” dhe është një nënshkrim, e që nuk dihet se i kujt është nënshkrimi dhe në emër të kujt po nënshkruhet.

Pritja kaq e gjatë e nxjerrjes së një njoftimi mbi vendimi, rreth 50 ditë, nga momenti i aprovimit të kërkesës për rishqyrtim dhe sjellja e këtij autorizimi na bënë të dyshojmë se nuk ka ekzistuar alternative tjetër për të tentuar të mbulohet kjo parregullsi në lidhje me nënshkrimin e këtyre dokumenteve, përveç përpjekjes që të ofrohet një autorizim të kujt do që e kanë pasur më herët, që të tentohet të mbulohet kjo mangësi e OE të rekomanduar për kontratë. të ulëta dhe me çmime që nuk mund ta përmbush kontratën.

Siç shihet tek përshkrimi i çmimeve, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim total dhe shpenzime doganore prej 109.00 € dhe çmim total prej:6,381.572.14 €, e që rezulton se nuk mund ta përmbush kontratën me këto çmime.

Me këtë çmim të ofruar, OE i rekomanduar për kontratë jo që nuk ka fitim në këtë tender por nuk mund ta sjell deri tek KEK mazutin.

Më poshtë po ua bashkëngjisim tri oferta të furnizuesve të ndryshëm, e që këta furnizues i ka cekur edhe vetë OE i rekomanduar për kontratë.

1. Prodhuksi Lotus OIL Bullgari:

2. Prodhuesi PETROLEUN SA-Hellenic Greqi:

3. Prodhuesi SllovaNafti Sllovaki

Siç shihet nga sqarimet dhe dëshmitë të cilat i bashkëngjitëm në këtë kërkesë për rishqyrtim kuptohet qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është me çmim jo normalisht të ulët, madje çmimet e vendosura në ofertë janë çmime imagjinare e që nuk kanë asnjë mbështetje të ndonjë prodhues/furnizues.

Për më tepër, ky fakt mund të vërtetohet nëse komunikohet me prodhuesit për të vërtetuar pretendimin tonë ankimor në lidhje me ofertat e tyre. Prandaj e inkurajojmë edhe ekspertin shqyrtues që të vërtetojë këtë pretendim.

Ne kemi kërkuar edhe në kërkesën për rishqyrtim të dt.02.04.2024 që AK-ja ti drejtohet prodhuesve, mirëpo nuk jemi në dijeni që është ndërmarr një veprim i tillë nga ana e tyre.

Autoriteti kontraktues është dashur ti analizojë çmimet e OE të rekomanduar për kontratë dhe eventualisht të kërkojë sqarime se a mund ta implementojë këtë kontratë OE i rekomanduar për kontratë, e jo automatikisht ta shpall fitues pa një analizë të saktë të çmimeve.

Ne me dt.04.06.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që vendimin e saj nuk e ka arsyetuar fare.

Autoriteti kontraktues në mungesë të argumenteve për të kundërshtuar pretendimet tona ankimore, vetëm ka sqaruar se ka kërkuar sqarime dhe pas pranimit të dokumenteve/autorizimit ka marr vendim.kjo përgjigje nuk ka të bëjë fare me realitetin dhe me dëshmitë që janë prezantuar, prandaj në mungesë të argumenteve të AK-së, konsiderojmë se edhe vetë AK-së në mënyrë implicite ka pranuar papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

Për neve është shumë e paqartë se si ka ardh në përfundim autoriteti kontraktues përkatësisht komisioni se nënshkrimi i kontestuar është i Fatbardh Muharremi. Për të vërtetuar se nënshkrimi është i një personi, duhet ekspertizë apo duhet të krahasohen nënshkrimet nga dokumente të kaluara, ndërsa në këtë rast autoriteti kontraktues e ka pranuar si nënshkrim të Fatbardh Muharremi në mënyrë të njëanshme, pa ndonjë analizë apo ekspertizë, prandaj nga këto veprime të AK-së, kuptohet favorizimi që i është bërë OE të rekomanduar për kontratë.

Tek nënshkrimi në paramasë nuk është vendosur fjala PËR, tek emri Lum Muharremi, por është vendos tek rubrika nënshkrimi konkretisht para nënshkrimit, prandaj nga ky fakt nuk dihet se kush ka nënshkrua dhe për kënd ka nënshkrua.Sa i përket pretendimit tjetër në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta, autoriteti kontraktues ka dhënë përgjigjen si më poshtë:

Pretendimi tjetër i juaji qe oferta e propozuar për dhëni te kontratës është ofertë jo-normalisht të ulëta nuk qëndron sepse bazuar ne raportin e hapjes se ofertave nuk konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo- normalisht i ulët, pra nuk përmbushen të gjitha sipas nenit Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, paragrafi 41,3,

Autoriteti kontraktues i është referuar vetëm nenit 41.3 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, mirëpo në këto raste mund të kërkohen sqarime dhe mund të konsiderohen ofertat me çmime jo normalisht të ulëta edhe për arsye të tjera, siç parashihet në nenin 41.4, 41.5, 41.6 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, prandaj autoriteti kontraktues ka marr parasysh vetëm pjesërisht dispozitat e Rregullores së lartpërmendur dhe atë e ka marr parasysh vetëm të favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

Me këto veprime kuptohet që nuk është respektuar neni 61 i LPP-së dhe neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Realisht autoriteti kontraktues duke mos dhënë arsyetime në vendimin për refuzim ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 9 të LPP-së.

Pra, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së, sepse oferta e OE të rekomanduar është dashur të konsiderohet ofertë me çmim jo normalisht të ulët.

Në këtë rast nuk është respektuar edhe neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik sepse fillimisht AK-së nuk ka kërkuar sqarime dhe se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arsyetuar se si mund ta realizojë kontratën me këtë çmim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 të LPP-së, ku Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu neni 7 paragrafi 6 pika (vi) e LPP-së ceket „që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse“\ ndërsa në këtë rast oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk përputhet me të gjitha kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 52, 59, 60, 61, 69 dhe 72 si dhe nenin 40 dhe 41 rregullores 001/2022 për prokurim publik. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrin: të Aprovohet, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE “PATRONI” SH.P.K,te Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jeni të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 25/06/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0513/24, ndërsa me datë 10/07/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0513 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK është pajtuar me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se duhet mbajtur seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin. Andaj, kjo seancë është mbajtur me dt. 14.08.2024, ku morën pjesë të gjitha palët në procedurë, përfshirë përfaqësuesin e AK, përfaqësuesin e OE dhe eksperti shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “PATRONI” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0513 ka vlerësuar si në vijim:

- Sqarim hyrës, Autoriteti Kontraktues (AK), KËRKUESI ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka aplikuar procedurë të hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës furnizim dhe vlera e parashikuar e kontratës është në vlerë prej: 6,650,000.00 €, AK me datë: 22.05.2024 kishte publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së pas Ri vlerësimit në sistemin elektronik ka rekomanduar për kontratë, Ex Fix, Sheshi Bill Clinton, Prishtinë me çmimin premiumin për 1 ton lëndë djegëse 109.00 € ndërsa në vlerë totale prej: 6,381,572.14 €.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1: “Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit e që pretendimi ankues i cili ka të bëjë me nënshkrimin e dokumentacionit të dosjes së tenderit deklaratën për afat të liferimit dhe përshkrimin e çmimeve (paramanën dhe llogarinë), AK pasi e ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe me datën: 17.05.2024 ka kërkuar sqarime përmes, (B47) Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit dhe konform nenit 72 të LPP-së, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë paragrafi 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, në këtë rast Operatori ekonomik është përgjigjur kërkesë për sqarimet e kërkuara nga AK me datën: 17.05.2024 dhe konfirmon se z. Fatbardh Muharremi është person i autorizuar i kompanisë “EX FIS” Shpk i cili i ka nënshkruar dokumentet si: Deklaratën për afat të liferimit dhe përshkrimin e çmimeve (paramanën dhe llogarinë) po ashtu është bashkangjitur, Autorizim nga Noteri me titull: AUTORIZIM I PËRGJITHSHËM PËR PËRFAQËSIM me Nr: LRP. Nr. 0246/2022 me të cilin Lum Muharremi

e autorizon Fatbardh Muharremin për përfaqësim të kompanisë “Ex Fis” SH.P.K i cili autorizim është bërë para njoftimit për kontratë/hapjes së tenderëve (në vitin 2022), duke e parë se ekzistenca e autorizimit figuron para hapje së tenderëve dhe në harmoni me nenin 72 të LPP-së, për mendimin ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm”.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2: “Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit e që pretendimi ankimor i cili ka të bëjë me çmimin jo normalisht i ulët. Operatori ekonomik Patroni SHPK, nuk ka ofruar fakte bindëse/konkrete se operatori ekonomik (OE) i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime të e tenderit jo-normalisht të ulët por ka ofruar vetën një përshkrim tabelë të çmimeve mes furnizuesve të ndryshëm, pa dhënë prova dhe argumente bindëse të furnizuesve të cilët i paraqet në ankesë. P.sh. oferta, pro fatura apo fatura apo çdo element tjetër që dëshmohet përmes provave dhe fakteve në mënyre që të argumentohen çmimet e tregut!....

Gjithashtu, në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, procedura për shqyrtimi e çmimeve jo normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-se. Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së.

Përshkrimin e çmimeve si dhe të respektohet kriteret e dhënies, pasi që çmimi total i ofertave (tenderuesve) është i përafërte dhe brenda vlerës së parashikuar nga AK, si dhe nuk mund të aplikohet neni 41.3 i Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik. citoj: 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Andaj, ky pretendim ankimor nga OE PATRONI SH.P.K Fushë Kosovë është e pabazuar për ekspertin shqyrtues”.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Meqenëse kjo ankesë ka të bëjë me dy pretendime ankimore për të cilat paneli shqyrtues nuk mund ti fal besimin ekspertit shqyrtues për faktin se sipas raportit të ekspertizës të dorëzuar nga eksperti shqyrtues shihet se të dy pretendimet nuk i ka trajtuar në substancë ashtu siç kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP.

Përkritazi me pretendimin e parë ku janë kontestuar nënshkrimet tek deklarata për afat të liferimit dhe nënshkrimit tek paramasa me përshkrim të çmimit, paneli shqyrtues lidhur me këtë pretendim ka analizuar të dy dokumentet ku kontestohet nënshkrimi i tyre dhe ka vërejtur se nënshkrimet e vendosura në këto dokumente dallojnë dhe nuk janë identike me nënshkrimet e vendosura tek deklarata në betim, deklarata për specifikime teknik dhe deklarata e prodhuesit.

Paneli shqyrtues konkretisht ka vërejtur se nënshkrimet tek deklarata në betim,deklarata për specifikime teknik dhe deklarata e prodhuesit janë të Drejtorit Lum Muharremi, kurse tek deklarata për afat të liferimit dhe nënshkrim tek paramasa me përshkrim të çmimit nuk janë identike me nënshkrimin e Drejtorit, pra ndryshojnë dhe ka mos përputhje të nënshkrimeve tek dokumentet e prezantuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Sa i përket nënshkrimeve të vendosura te dy dokumentet e kontestuar përkatësisht tek deklarata për afat të liferimit dhe tek paramasa me përshkrim të çmimit, paneli shqyrtues ka analizuar këto dy nënshkrime dhe ka ardh në përfundim se autoriteti kontraktues e as eksperti shqyrtues nuk kanë dëshmuar se nënshkrimet e vendosura në këto dy dokumente janë të personit për të cilin pretendon OE i rekomanduar për kontratë dhe për të cilin ka bashkëngjitur një autorizim me rastin e sqarimeve shtesë.

Madje eksperti shqyrtues edhe në seancën dëgjimore të dt.14.08.2024 nuk ka marr përgjegjësinë se janë vërtetuar nënshkrimet e këtyre dy dokumenteve dhe nuk ka marr përgjegjësinë se këto dy nënshkrime janë të personit, për të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur autorizimin me sqarime shtesë.

Për më tepër gjatë analizës së nënshkrimeve të këtyre dy dokumenteve, paneli shqyrtues ka vërejtur se nënshkrimet në këto dy dokumente nuk janë të vendosura në formatin dhe mënyrën e njëjtë, pasi që tek paramasa me përshkrim të çmimit, tek rubrika e nënshkrimit është shënuar fjala “**për**” dhe është vendosur nënshkrimi i cili nuk është vërtetuar as nga autoriteti kontraktues e as nga eksperti shqyrtues se i cilit person është.

Ndërsa tek deklarata për afat të liferimit tek rubrika e nënshkrimit është vendosur nënshkrimi i njëjtë sikurse tek paramasa me përshkrim të çmimit, mirëpo në këtë rubrikë e as në rubrikat tjera nuk është vendosur fjala “**për**” dhe kjo për panelin shqyrtues dëshmon pa rregullsi të nënshkrimit të këtyre dokumenteve përkatësisht mënyrës së nënshkrimit të këtyre dokumenteve dhe dëshmon pamundësinë e vërtetimit nga ana e AK dhe e ekspertit shqyrtues të këtyre nënshkrimeve.

Në vijim janë të paraqitura dokumentet me nënshkrimet e personit për të cilin nuk ka dëhsmi se është i autorizuar për nënshkrim të këtyre dokumenteve.



Identifikim i operatorit ekonomik (OE)
Emri i OE: Ex Fis Sh.P.K
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE: Lum Muharremi
Nënshkrimi: <i>për: Fatbardh Muharremi</i>
data: 27.02.2024
vula:



Ndërsa në vijim është i paraqitur nënshkrimi i Drejtorit të OE të rekomanduar për kontratë:

Lum Muharremi
Drejtore
044 185 360
lum.muharremi@exfis.com

Nënshkrimi *[Signature]*

Vula 

EX FIS, Blvd Bill Clinton 407 Prishtinë. Tel: +381 38/ 525 183. 544 916. Fax: +381 38/ 524 584. www.exfis.com

Po ashtu edhe përfaqësuesja e AK përmes emailit të dt. 15.08.2024, ju ka drejtuar OSHP duke ofruar edhe një autorizim ku për nënshkrimin e kësaj kontrate autorizohet një person tjetër nga z. F.M, në të cilin autorizim vërehet një nënshkrim jo i ngjashëm edhe me nënshkrimet e sipërpërmendura tek deklarata për afat të liferimit dhe tek paramasa me përshkrim të çmimit.

Prishtinë, 11.08.2022

Dhënësi i Autorizimit

Fatbardh Muharremi
[Signature]


Për më shumë në lidhje me autorizimet për nënshkrim të dokumenteve të tenderit, KRPP ka lëshuar një opinion me dt. 24.10.2023 tek pyetjet e shpeshta përkatësisht pyetja me nr.14, ku ka sqaruar se domosdoshmërisht për ti nënshkruar dokumentet e tenderit një person tjetër duhet të jetë i autorizuar për këtë qëllim, ndërsa në rastin konkret nuk është dëshmuar dhe vërtetuar nga autoriteti kontraktues e as nga eksperti shqyrtues se nënshkrimi i dy dokumenteve është i personit të autorizuar, prandaj ky fakt për panelin shqyrtues dëshmon papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë. Dhe nevojën që AK të veproj konform nenit 52.7 të LPP.

Përkitazi me pretendimin e dytë të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, paneli shqyrtues duke pasur parasysh kompetencat dhe vendimmarrjen në lidhje me këtë çështje, sqaron se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është përgjegjësi e AK sipas nenit 59 të LPP, duke përfshirë edhe analizën për çmime jo normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP dhe nenit 41 të Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik. Mirëpo AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 61 të LPP edhe pse ka qenë pretendim i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta e ku i njëjti ka prezantuar tri tabela të tri rafinerive të shteteve të ndryshme me çmime të ndryshme përkatësisht çmime më të larta në raport me vlerën e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, prandaj AK është dashur të përgjigjet në pretendimet ankimore dhe të trajtojë këtë pretendim sipas nenit 61 të LPP dhe nenit 41.3, 41.4, 41.5 dhe 41.6 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim publik.

Gjithashtu bazuar në konstatimin e ekspertit shqyrtues shihet që i njëjti nuk e ka trajtuar pretendimin ankimor sipas nenin 61 të LPP dhe 41 të Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik, sepse nuk ka bërë ndonjë analizë e as hulumtim të çmimeve të tregut.

Pavarësisht që në rastet kur përmbushen të tri kushtet sipas nenit 41.3 të Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik për të kërkuar sqarime ashtu siç e ka përmendur eksperti shqyrtues, paragrafët tjerë të kësaj dispozite përcaktojnë mundësi dhe situata të tjera për të kërkuar sqarime kur tenderët duken me çmime jo normalisht të ulët, prandaj autoriteti kontraktues dhe eksperti shqyrtues në kuptim të këtyre dispozitave dhe rrethanave faktike duhet ti ketë parasysh të gjitha dispozitat dhe kur dëshmitë, faktet dhe rrethanat janë të atilla për të sqaruar çmimet eventuale jo normalisht të ulëta duhet zbatuar këto dispozita. Sipas RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, për te plotësuar kushtin që një Operator qe te këtë çmim jo normalisht te ulet duhet te plotësohen disa kritere dhe dispozita tjetër 41.4, e cila citon: "*Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së*".

Duke pasur parasysh ato që u thanë më lartë si dhe dëshmitë dhe shkresat e lëndës, paneli shqyrtues sqaron se në lidhje me këtë çështje nuk janë zbatuar dispozitat e nenit 61 të LPP dhe nenin 41 Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - PATRONI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: